

Akademia e Shkencave e Shqipërisë presso Academy of Sciences of Albania.

26 luglio alle ore 19:23 · Tirana, Tirana County, Albania ·

Nekrologji

Ndahet nga jeta prof. Antonino Guzzetta

Një dhimbje e rëndë ka goditur albanologjinë. Mbrëmë natën, pas një lëngimi të gjatë, u nda nga jeta prof. Antonino Guzzetta.

I lindur në Piana degli Albanesi më 14 tetor 1922, Antonino Guzzetta u formua së pari në Seminarin greko-shqiptar të Palermos, themeluar nga At Giorgio Guzzetta, që do të ishte një pikë referimi për gjithë veprimtarinë e tij të mëpasme. Në rininë e tij ai iu përkushtua konsolidimit të aparkisë së Piana degli Albanesi, sipas këshillave të Rosolino Petrotta-s, që më pas do të ishte dhe mentori i tij.

I rikthyer në vendlindje, pas viteve të vështira të Luftës, Antonino Guzzetta u lauria në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë në Universitetin e Palermos. Në këtë periudhë ai mori mësimë prej studiuesish të mirënjohur të albanologjisë, si Gaetano Petrotta, Marco la Piana, Giuseppe Valentini, Marcello Durante, Riccardo Ambrosini. Shumë shpejt u bë një prej bashkëpunëtorëve të tyre, në fillim si asistent vullnetar dhe më fonë si pedagog i fonetikës dhe gjuhësisë së përgjithshme.

Më 1974 u emërua profesor i rregullt i gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe në këtë detyrë shumë shpejt riktheu në jetë katedrën më të hershme të albanologjisë në Itali, që ishte ngritur në krye të herës, më 1900, pranë Institutit Oriental të Napolit. Pas një viti u transferua në Palermo, i ngarkuar me detyrën e drejtorit të Institutit të Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Fakultetin e Letërsisë dhe të Filozofisë në Universitetin e Palermos. Në vitet 1987-1990, me daljen në pension të mikut të tij të madh prof. Francesco Solano, Antonino Guzzetta dha mësim pranë Universitetit të Studimeve në Kalabri, duke siguruar vazhdimësinë shkencore dhe didaktike të njërës prej katedrave albanologjike më të vlerësuara në shkallë ndërkombëtare. Veprimtaria universitare e prof. Antonino Guzzetta-s në këtë kohë u shqua për organizim efikas, në mënyrë të veçantë për rritjen e interesit të të rinjve në aulat palermitane.

Që nga viti 1968 prof. Antonino Guzzetta mbajti detyrën e drejtorit të Centro Internazionale di Studi Albanesi që mban emrin e Rosolino Petrotta-s, e mirënjohur dhe me prestigj të lartë shkencor në Itali e në shkallë europiane, ku ai zhvilloi një numër të madh veprimtarish ndërkombëtare, kongrese dhe seminare, që patën si rezultat të denjë botime me nivel të lartë. Janë plot 23 kongreset ndërkombëtare të studimeve shqiptare që prof. Antonino Guzzetta organizoi midis viteve 1973-1997, duke e shndërruar qendrën që drejtoi në një pikëtakimi të shumicës së studiuesve albanologë që e ushtronin veprimtarinë e tyre në Perëndim (Francë, Gjermani, Austri, Rusi, Greqi, SHBA). Që nga viti 1991 në këto kongrese morën pjesë edhe studiues nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia. Nuk është aspak e rastit që ai luajti një rol ndërmjetësuesi për bashkëpunim të shpejtë edhe me këta studiues, menjëherë pas daljes prej regjimeve totalitare.

Midis kontributeve të tjera shkencore, vlen të përmendet drejtimi i kolanës shkencore Albanica, të cilën ai vetë e themeloi dhe e bëri të suksesshme me botimin e shumë monografive dhe përmbledhjeve me studime e burime. Në aspektin qytetar, veçohet roli i tij në mbrojtje të së ardhmes së katedrës së gjuhës shqipe, për të ardhmen e së cilës ai luftoi me këmbëngulje. Ai pati meritën të bashkonte në këto përpjekje edhe kolegë studiues të shumtë italianë e të huaj.

Midis studimeve të shumta të prof. Antonino Guzzetta-s në fusha të ndryshme si letërsia, dialektologjia, historia, folklori, shenjojmë:

1. Tracce della lingua albanese nel secolo XV nella documentazione veneta dell'epoca (Palermo, 1968);
2. Ernest Koliqi, un poeta sociale (Palermo, 1968);
3. Tracce della lingua albanese del secolo XV nella documentazione veneta dell'epoca (Palermo, 1973);
4. L'incanto del vero: i racconti di Ernest Koliqi fra tradizione e rinnovamento (Palermo, 1974);
5. La parlata di Piana degli Albanesi, Parte I - Fonologia (Palermo, 1978);
6. La donna e il serpente: lettura di due fiabe italo-albanesi (Palermo, 1978);
7. Byron in Albania (Palermo 1978);
8. Paraklisis: Gjitheshejtes mëmë te t'in'Zoti. Presentazione a cura di Antonino Guzzetta (Palermo, 1982);
9. L'etnia albanese in Italia (Palermo, 1988);
10. Il ruolo della scuola per la difesa dell'etnia arbëreshe (Palermo, 1988);
11. I rapporti Arbëresho-Shqiptarë attraverso i secoli (Palermo, 1989);
12. Descrizione fonematica della parlata arbëreshe di Contessa Entellina in Sicilia (Palermo, 1983);

13. Per una descrizione funzionale della morfologia del sostantivo nella parlata arbreshe di Contessa Entellina (Palermo, 1986)

Prof. Antonino Guzzetta ishte i rrethuar prej miqsh të tillë të shquar si Eric P. Hamp, Titos Jochalas, Walter Breu, Riccardo Ambrosini a Tullio De Mauro, Antonino Buttita a Giovan Battista Pellegrini, John Trumper e Leonardo M. Savoia, përkrah me studiuesit shqiptarë Ernest Koliqi e Martin Camaj, Àt Marlekaj, Shaban Demiraj, Jorgo Bulu e Gjovalin Shkurtaj dhe atyre arbëreshë si Francesco Solano, Francesco Altimari e Matteo Mandalà.

Prof. Antonino Guzzetta ishte fitues i disa mirënjohjeve ndërkombëtare, duke përfshirë çmimin Naim Frashëri, akorduar me propozim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 1992, me motivacionin për kontribute të çmuara për zhvillimin e albanologjisë në shkallë ndërkombëtare.

Arbëreshët e përcjellin për në banesën e përjetshme prof. Antonino Guzzetta-n me dhimbjen që shprehin fjalët: Të kemi dashur sempri mirë.

[Visualizza traduzione](#)

